

Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI)

Mars 2026

Procesi i vlerësimit (due diligence) mjedisor dhe social (ESDD):
Projekti për forcimin e rrjetit të transmetimit të KOSTT



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D.



OFFICIAL USE



Përmbajtja

Akronimet dhe shkurtesat	3
1. Hyrje dhe përshkrimi i projektit.....	4
1.1 Përshkrimi i Projektit	4
1.2 Përmbledhje e shkurtër e ndikimeve dhe rreziqeve të projektit.....	4
2. Objektivi/Përshkrimi i PAPI	5
2.1 Metodologjia.....	5
3. Korniza ligjore dhe rregullatore për angazhimin e palëve të interesit	5
4. Identifikimi dhe analiza e palëve të interesit.....	5
4.1 Palët e prekura nga projekti	6
4.2 Palë të tjera të interesit.....	6
4.3 Grupet në pozitë të pafavorshme / grupe të cenueshme	7
4.4 Masat e përshtatura të angazhimit të palëve të interesit (grupet në pozitë të pafavorshme / grupe të cenueshme).....	7
5. Programi i angazhimit të palëve të interesit	9
5.1 Qëllimi dhe kohëzgjatja e programit të angazhimit të palëve të interesit.....	9
5.2 Përmbledhje e nevojave të palëve të interesit, me metodat, mjetet dhe teknikat për publikimin e informacionit dhe angazhimin.....	9
5.3 Strategjia për publikimin e informacionit dhe konsultimet	11
5.4 Strategjia e propozuar për përfshirjen e pikëpamjeve të grupeve të cenueshme	11
6. Shqyrtimi i komenteve / raportimi ndaj palëve të interesit	12
7. Burimet financiare dhe kapacitetet institucionale për zbatimin e angazhimit të palëve të interesit.....	12
7.1 Burimet	12
7.2 Funkcionet menaxheriale dhe përgjegjësitë	13
8. Mekanizmi për trajtimin e ankesave (MTA).....	14
8.1 Menaxhimi i mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA).....	15
8.2 Monitorimi dhe raportimi i mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA).....	17
9. Monitorimi dhe raportimi	17
10. Publikimi dhe konsultimi.....	18
Shtojca 1: Korniza ligjore dhe rregullatore për angazhimin e palëve të interesit.....	19
Korniza ligjore kombëtare e Kosovës për angazhimin e palëve të interesit	19
Politikat e BERZH-it për angazhimin e palëve të interesit.....	19
Shtojca 2: Strategjia e propozuar për publikimin e informacionit dhe konsultimet	21
Shtojca 3: Përmbledhje e aktiviteteve të mëparshme të angazhimit të palëve të interesit.....	23
Shtojca 4: Model i formularit të ankesës	24
Shtojca 5: Shembull i një modeli të thjeshtë të regjistrimit të ankesave	26



Akronimet dhe shkurtesat

M&S	Mjedisore dhe Sociale
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
PVMS	Plani i veprimtimit mjedisor dhe social
ESDD	Procesi i vlerësimit (due diligence) mjedisor dhe social
PMMS	Plani i menaxhimit mjedisor dhe social
PMS	Politika Mjedisore dhe Sociale
BE	Bashkimi Evropian
MTA	Mekanizmi për trajtimin e ankesave
KEDS	Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike KEDS sh.a.
AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Kosovës SH.A.
ME	Ministria e Ekonomisë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MTA	Mekanizmi për trajtimin e ankesave
PJT	Përmbledhje jo-teknike
KP	Kërkesa e Performancës
SAS/SH	Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual dhe ngacmimi seksual
PAPI	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit



1. Hyrje dhe përshkrimi i projektit

1.1 Përshkrimi i Projektit

Ky plan për angazhimin e palëve të interesit (PAPI) përshkruan aktivitetet për projektin e përforsimit të rrjetit të transmetimit të KOSTT, një iniciativë e financuar nga BERZH me qëllim rritjen e besueshmërisë, efikasitetit dhe kapacitetit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë. Projekti mbështet integrimin e deri në 300 MW nga burime të energjisë së ripërtërishme dhe është në përputhje me standardet e ENTSO-E. Me një kosto totale prej 23.25 milionë eurosh, duke përfshirë 22.5 milionë euro nga BERZH, projekti zbatohet nga KOSTT, Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut të Kosovës, në pronësi të plotë të Republikës së Kosovës.

KOSTT është përgjegjës për transmetimin e energjisë elektrike, balancimin e sistemit elektroenergjetik dhe operimin e tregut. Projekti përfshin:

- Rehabilitimin e nënstacioneve 110/10kV në Klinë dhe Burim
- Rivitalizimin e pajisjeve të tensionit të lartë në Vushtrri dhe Vallaq
- Përmirësimin e linjës 110kV dhe ndërtimin e një linje të re me qark të vetëm në Prizren
- Zëvendësimin e transformatorëve në Gjilan dhe Viti
- Instalimin e një transformatori të dytë në Gjilan 5
- Zëvendësimin e transformatorëve të vjetëruar në Gjakova 1 & 2, Gjilan 1, Viti, Prishtina 1, Vushtrri 1, Skenderaj dhe Prizren 3
- Përmirësimin e linjave të transmetimit Prizren 1–3 për rritjen e kapacitetit dhe përmbushjen e kriterit N-1
- Revitalizimin e pajisjeve të nënstacioneve në Vallaq dhe Vushtrri 1

Këto investime synojnë të reduktojnë ndërprerjet e furnizimit, të përmirësojnë qëndrueshmërinë e rrjetit dhe të mbështesin zhvillimin ekonomik. Projekti zbatohet në përputhje me politikën mjedisore dhe sociale të BERZH-it (2019), duke respektuar në veçanti kërkesën për performancë 10 (KP 10) për publikimin e informacionit dhe angazhimin e palëve të interesit. Kjo kërkon konsultim kuptimplotë, gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm nga ana kulturore gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit.

1.2 Përmbledhje e shkurtër e ndikimeve dhe rreziqeve të projektit

Projekti i zhvillimit të rrjetit të transmetimit të KOSTT klasifikohet si Kategoria "B" sipas politikës mjedisore dhe sociale të BERZH-it (2019), që do të thotë se ndikimet e tij të mundshme mjedisore dhe sociale janë specifike për vendin dhe të menaxhueshme përmes masave të përshtatshme zbutëse. Fushëveprimi i vlerësimit përcaktohet rast pas rasti.

Rreziqet kryesore lidhen me punimet civile për rehabilitimin dhe modernizimin e nënstacioneve, linjave të transmetimit dhe transformatorëve. Ndërsa ndikimi afatgjatë pritet të jetë shumë pozitiv përmes përmirësimit të besueshmërisë së furnizimit me energji, mbështetjes së integritetit të energjisë së ripërtërishme dhe zhvillimit rajonal, janë identifikuar disa rreziqe afatshkurtra.

Rreziqet mjedisore përfshijnë ndotjen e ajrit dhe zhurmën, gjenerimin e mbeturinave dhe erozionin e tokës gjatë fazës së ndërtimit, veçanërisht me përdorimin e pajisjeve të rënda. Trajtimi i materialeve të rrezikshme, siç është vaji i transformatorit dhe pajisjet që përmbajnë SF₆, paraqet rreziqe kontaminimi nëse nuk menaxhohet siç duhet. Megjithatë nuk priten ndikime të konsiderueshme në biodiversitet, mund të ndodhin ndërprerje të vogla në ekosisteme dhe avifaunë. Rezistenca e infrastrukturës ndaj motit ekstrem do të jetë gjithashtu thelbësore.

Rreziqet sociale lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, ekspozimin e komunitetit ndaj rreziqeve që lidhen me ndërtimin dhe kufizimet e mundshme të përkohshme të qasjes ose përdorimit të tokës. Ndërsa nuk parashikohet blerje toke në shkallë të gjerë, projekti mund të përfshijë blerje të kufizuara dhe të përkohshme toke dhe zhvendosje të vogla ekonomike. Komunikimi efektiv dhe angazhimi i palëve të Interesit do të jenë thelbësore për minimizimin e ndikimeve në komunitet dhe zgjidhjen e ankesave.

Rreziku i VSM/SH konsiderohet i ulët për shkak të punimeve civile në shkallë të kufizuara dhe përdorimit të fuqisë punëtore vendase. Megjithatë, fushatat ndërgjegjësuëse, ndërgjegjësimi për komunitetin dhe një mekanizëm për trajtimin e ankesave (MTA) do të ndihmojnë në zbutjen e këtij rreziku.



Menaxhimi i rreziqeve do të udhëhiqet nga plani i veprimit mjedisor dhe social (PVMS), plani i angazhimit të palëve të interesit (PAPI) dhe përmbledhja jo-teknike (PJT), të mbështetura nga komunikim i synuar, ngritje e kapaciteteve dhe plane specifike të menaxhimit mjedisor dhe social për secilin lokacion (PMMS). Në tërësi, rreziqet janë të lokalizuara dhe të kontrollueshme, me masa zbutëse të harmonizuara me kërkesat për performancë të BERZH-it.

2. Objektivi/Përshkrimi i PAPI

2.1 Metodologjia

Objektivi i përgjithshëm i këtij plani të angazhimit të palëve të interesit (PAPI) është të krijojë një program të strukturuar të angazhimit të palëve të interesit, duke përfshirë publikimin e informacionit dhe konsultimet gjatë gjithë ciklit të projektit. Ai përcakton mënyrën se si ekipi i projektit do të komunikojë me palët e interesit dhe ofron një mekanizëm për të ngritur shqetësime, paraqitjen e komenteve ose dorëzimin e ankesave lidhur me aktivitetet e projektit.

Për të qenë në përputhje me praktikën më të mira, projekti do të zbatojë këto parime:

- *Qasje e hapur gjatë gjithë ciklit të projektit:* Konsultimet publike do të zhvillohen gjatë gjithë zbatimit të projektit, në mënyrë të hapur dhe pa manipulim, ndërhyrje apo presion.
- *Pjesëmarrje e informuar dhe reagim ndaj komenteve:* Palëve të interesit do t'u ofrohet informacion i plotë, në kohë dhe në formë të kuptueshme për projektin, në mënyrë që të mund të japin mendime, shqetësime dhe sugjerime, të cilat do të shqyrtohen dhe adresohen.
- *Gjithëpërfshirje dhe ndjeshmëri:* Procesi i angazhimit do të jetë gjithëpërfshirës, duke siguruar qasje të barabartë në informacion. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet grupeve të cënueshme (si gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat e zhvendosur, migrantët dhe pakicat etnike), përmes qasjeve të përshtatshme nga ana kulturore.
- *Fleksibilitet:* Metodatat e angazhimit do të përshtaten sipas nevojës, përfshirë përdorimin e formateve online ose përmes telefonit kur ndërveprimi fizik është i kufizuar për arsye sociale, kulturore ose sigurie.

Institucionet zbatuese do të sigurojnë konsultim kuptimplotë, në përputhje me kërkesën për performancë 10 (KP10) të BERZH-it, e cila thekson angazhimin dypalësh, gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm. Karakteristikat kryesore përfshijnë:

- Konsultime të hershme për të informuar hartimin e projektit;
- Angazhim i vazhdueshëm ndërsa rreziqet dhe ndikimet evoluojnë;
- Publikim në kohë të informacionit të qartë, relevant dhe të qashtë, në gjuhë dhe formate të përshtatshme;
- Reagim ndaj komenteve të pranuar;
- Mbrojtje nga presioni apo diskriminimi;
- Dokumentim dhe publikim të procesit të konsultimit.

3. Korniza ligjore dhe rregullatore për angazhimin e palëve të interesit

Korniza ligjore kombëtare për angazhimin e palëve të interesit dhe politikat e BERZH-it mbi angazhimin e palëve të interesit paraqiten në Shtojcën 1 të këtij raporti.

4. Identifikimi dhe analiza e palëve të interesit

Palët e Interesit të projektit përkufizohen si individë, grupe ose subjekte të tjera që:

- ndikohen ose ka të ngjarë të ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, pozitivisht ose negativisht, nga projekti (të njohur edhe si 'palë të prekura'); dhe
- mund të kenë interes në projekt ('palë të interesit'). Ato përfshijnë individë ose grupe, interesat e të cilëve mund të preken nga projekti dhe që kanë potencial të ndikojnë në rezultatet e projektit në çfarëdo mënyre.

Në mënyrë më specifike, kërkesa për performancë KP 10 e BERZH-it njeh tri kategori të gjera të palëve të interesit:



- **Palët e prekura nga projekti:** Individë ose grupe që ka gjasa të përfshihen ndikime reale ose të mundshme, negative ose pozitive, në mjedisin e tyre fizik, shëndet, siguri, praktika kulturore, mirëqenie ose mjete jetese si rezultat i projektit. Kjo kategori përfshin komunitetet lokale dhe ata që ka më shumë gjasa të vërejnë ndryshime si pasojë e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit.
- **Palë të tjera të interesit (PTI):** Individë, grupe ose organizata që kanë interes në projekt, shpesh për shkak të lokacionit, karakteristikave, ndikimeve ose çështjeve me interes publik. Shembuj përfshijnë autoritetet rregullatore, zyrtarët qeveritarë, sektorin privat, komunitetin shkencor, akademikët, sindikatat, organizatat e grave, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat kulturore.
- **Individë ose grupe të cënueshme / në pozitë të pafavorshme:** Është thelbësore të vlerësohet nëse ndikimet e projektit prekin në mënyrë disproporcionale individë ose grupe të cënueshme, të cilët mund të mos kenë mundësi të mjaftueshme për të shprehur shqetësimet e tyre ose për të kuptuar ndikimet e projektit, veçanërisht në kontekstin e këtij projekti.

4.1 Palët e prekura nga projekti

Këtu përfshihen individë, grupe ose komunitete të prekura drejtpërdrejt apo tërthorazi nga aktivitetet e projektit:

Tabela 1. Palët e Prekura nga Projekti

Palët e interesit	Përshkrimi / Shembuj	Ndikimi / Interesi i mundshëm
Komunitetet lokale / Banorët	Klinë, Burim, Prizren, Gjiçan, Viti, Vushtrri, Vallaq, Gjakovë, Skenderaj	Zhurma, pluhuri, ndërprerja e qasjes që lidhen me ndërtimin; përfitime afatgjata nga furnizimi më i qëndrueshëm me energji
Punëtorët e ndërtimit	Të angazhuar në të gjitha lokacionet e projektit	Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë në punë
Fermerët / Prodhuesit bujqësorë	Në afërsi të nënstacioneve ose trasesë së linjave (p.sh. Prizren, Gjakovë, Skenderaj)	Humbje e përkohshme e qasjes ose kufizime në përdorimin e tokës
Pronarët / Përdoruesit e tokës	Prona të prekura nga punimet, servitutet ose infrastruktura	Ndikime të përkohshme ose të përhershme në pronë
Familjet pranë infrastrukturës	Familje në afërsi të nënstacioneve apo linjave	Shqetësime vizuale, zhurmë, vibrime
Konsumatorët e energjisë	Amvisëri, biznese dhe përdorues industrialë në të gjithë Kosovën	Përmirësim i besueshmërisë së furnizimit dhe reduktim i ndërprerjeve

4.2 Palë të tjera të interesit

Këtu përfshihen individë, grupe apo organizata me interes në projekt për shkak të vendndodhjes, rëndësisë ose afërsisë së tij, megjithëse nuk preken drejtpërdrejt. Për projektin në fjalë, palë të tjera të interesit përfshijnë:

Tabela 2. Palë të tjera të interesit

Palët e interesit	Përshkrimi / Shembuj	Ndikimi / Interesi i mundshëm
Institucionet qeveritare	Ministria e ekonomisë (ME), Ministria e mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës (MMPHI), Zyra e rregullatorit për energji (ZRRE), Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës (AMMK), Agjencia për Menaxhimin Emergjent, Qendra Komunale për Trashëgimi Kulturore, komunat përkatëse	Mbikëqyrja e politikave, lëshimi i lejeve, koordinimi



Entitete të sektorit privat	KEDS, kontraktorë, furnizues, kompani energjetike	Koordinim teknik, furnizim me pajisje, ndërveprim me infrastrukturën
Institucione akademike / kërkimore	Universitete, institute kërkimore	Analiza teknike, monitorimi
Organizata të shoqërisë civile	OJQ në fushën e mjedisit ose mbështetjes së komunitetit	Monitorim, avokim dhe ndjekje e përputhshmërisë sociale/mjedisore
Palë ndërkombëtare	Bashkimi Evropian, donatorë, odat ekonomike, media	Mbikëqyrje, informim publik dhe integrim rajonal
Banorët në komunat përreth	Komunat afër zonave të projektit	Përfitime të tërthorta nga përmirësimi i shërbimeve energjetike

4.3 Grupet në pozitë të pafavorshme / grupe të cenueshme

Këtu përfshihen individë të cilët, për shkak të moshës, gjinisë, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike ose vështirësive ekonomike, mund të përballen me pengesa në pjesëmarrjen në projekt. Projekti do të promovojë përfshirjen e tyre përmes informimit të synuar, materialeve të qasshme dhe metodave të përshtatshme nga ana kulturore në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

Tabela 3. Grupet në pozitë të pafavorshme / grupe të cenueshme

Palët e interesit	Përshkrimi / Shembuj	Ndikimi / Interesi i mundshëm
Familjet me të ardhura të ulëta	Veçanërisht në zonat rurale	Rrezik më i lartë nga ndërprerjet e shërbimeve
Gratë (në zonat rurale)	Mund të përballen me pengesa në qasje ose pjesëmarrje	Nevojë për metoda gjithëpërfshirëse të angazhimit
Pakicat etnike	Komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe serb	Barrierat gjuhësore/sistematike në angazhim
Personat me aftësi të kufizuara	Kufizime fizike/shqisore	Nevojë për komunikim dhe ambiente të qasshme
Të moshuarit / persona me ndjeshmëri shëndetësore	Të moshuarit, individët me probleme shëndetësore	Më të ndjeshëm ndaj ndikimeve gjatë ndërtimit
Nxënësit / shkollat	Në afërsi të infrastrukturës së projektit	Nevojë për masa shtesë sigurie gjatë ndërtimit

4.4 Masat e përshtatura të angazhimit të palëve të interesit (grupet në pozitë të pafavorshme / grupe të cenueshme)

Tabela 4. Masat e përshtatura të angazhimit të palëve të interesit (grupet në pozitë të pafavorshme / grupe të cenueshme)

Grupi i palëve të interesit	Kufizime në angazhim	Masa / burime për të lehtësuar angazhimin
Familjet me të ardhura të ulëta dhe në pozitë të pafavorshme ekonomike në zonat e prekura	- Ndërgjegjësim i kufizuar rreth projektit - Mund të ketë mungesë qasjeje në teknologji për konsultime dixhitale - Kufizime financiare dhe kohore për të marrë pjesë në takime publike	- Organizimi i takimeve fizike në lokacione të qasshme - Materiale komunikimi të shtypura të shpërndara në ambiente shumë të frekuentuara në fshatra/zona rurale, duke përfshirë ndërtesat komunale, zyrat postare, dyqanet, shkollat, etj.
Gratë (veçanërisht në zonat rurale)	Si rezultat i normave diskriminuese me bazë gjinore, mund të ndiejnë se	Nëse është e nevojshme, do të organizohen konsultime të ndara vetëm për gratë (siç janë grupet e fokusit vetëm për gratë).



	angazhimi i tyre nuk është i rëndësishëm ose i nevojshëm. - Mund të ndihet në siklet duke marrë pjesë në ngjarje publike dhe/ose duke ndarë pikëpamjet dhe shqetësimet e saj para burrave - Përgjegjësitë familjare mund ta bëjnë të vështirë pjesëmarrjen në ngjarje që janë larg shtëpive të tyre ose që janë planifikuar në një kohë të caktuar.	- Zgjedhja e lokacioneve afër vendbanimeve - Planifikimi i orareve që nuk ndërhyjnë me obligimet familjare. - Shpërndarja e informacionit përmes kanaleve të ndryshme (radio, rrjete sociale, komunikim verbal), përfshirë materiale audio-vizuale për personat që nuk dinë të lexojnë ose shkruajnë
Pakicat etnike	- Mund të ndihet i padëshiruar për të marrë pjesë në evente (frika nga diskriminimi dhe/ose konflikti i mundshëm social) - Mund të ndihet i nën-përfaqësuar për shkak të barrierave gjuhësore	- Sigurohuni që të gjitha informacionet e publikuara të jenë të disponueshme në gjuhët zyrtare të Kosovës (d.m.th shqip, serbisht) dhe anglisht. - Kur është e nevojshme, siguroni përkthime ose interpretime për gjuhët e tjera të pakicave (p.sh., turqisht, boshnjakisht, rome) për të lehtësuar pjesëmarrjen kuptimplote. - Bashkëpunoni me OJQ-të lokale dhe/ose udhëheqësit e komunitetit për të lehtësuar angazhimin e tyre dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre, si dhe kërkoni mbështetje në organizimin e ngjarjeve gjithëpërfshirëse.
Personat me aftësi të kufizuara	- Pengesa fizike për pjesëmarrjen në evente (p.sh., vende të paarritshme) - Vështirësi në qasjen në platformat dixhitale (p.sh., dëmtime në shikim ose dëgjim) - Mungesë informimi të synuar	- Sigurohuni që vendet të jenë të qasshme për karrige me rrota dhe të pajisura me akomodimet e nevojshme për pjesëmarrësit me aftësi të kufizuara (p.sh., rampa, ashensorë, tualete të qasshme) - Siguroni përkthyes të gjuhës së shenjave, teknologji ndihmëse dhe materiale në formate të qasshme (p.sh., Braille, audio) nëse është e nevojshme. - Ofroni mundësi pjesëmarrjeje në distancë ose dixhitale për ata që nuk mund të marrin pjesë personalisht, duke siguruar qasshmëri (p.sh., titrat, përputhshmëria e lexuesit të ekranit)
Të moshuarit / persona me ndjeshmëri shëndetësore	- Pamundësia fizike për të marrë pjesë në konsultime - Ndjeshmëri më e lartë ndaj ndikimeve të ndërtimit, siç janë zhurma dhe pluhuri - Ofrimi i mundësive të konsultimeve (p.sh., telefon ose vizita në grupe të vogla)	Shpërndarja e informacionit në gjuhë të thjeshtë përmes ndërmjetësve të besueshëm (punonjës shëndetësorë, liderë komunitarë ose përfaqësues i komunitetit i kompanisë)
Nxënësit / shkollat (shkollat pranë lokacioneve të projektit)	- Rreziqet e sigurisë për shkak të afërsisë me aktivitetet e ndërtimit - Ndërprerje të funksionimit dhe rutinës shkollare - Zbatimi i protokolleve të rrepta sigurie pranë shkollave, duke përfshirë rrethimin e zonave të ndërtimit	- Planifikoni aktivitetet e ndërtimit për të minimizuar ndërprerjet e orarit të shkollës - Angazhimi me administratorët e shkollave për të komunikuar afatet kohore dhe masat e sigurisë



5. Programi i angazhimit të palëve të interesit

5.1 Qëllimi dhe kohëzgjatja e programit të angazhimit të palëve të interesit

Qëllimi i këtij programi të angazhimit të palëve të interesit është të sigurojë komunikim të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent me të gjitha palët e interesit gjatë gjithë ciklit të projektit. Objektivat specifike përfshijnë:

- Mbajtjen e një dialogu konstruktiv me komunitetet e prekura dhe palët e tjera të interesit.
- Identifikimin dhe angazhimin e palëve të interesit në fazë të hershme dhe në mënyrë të vazhdueshme.
- Integrimin e komenteve të palëve të interesit në projektim dhe zbatim.
- Sigurimin e pjesëmarrjes kuptimplote në bazë të parimeve të transparencës dhe mosdiskriminimit.
- Ofrimin e mundësive të barabarta për grupet e marginalizuara për të shprehur qëndrimet dhe shqetësimet e tyre.
- Sigurimin e publikimit në kohë dhe në mënyrë të qasshme të informacionit.
- Menaxhimin e pritshmërive dhe adresimin e keqkuptimeve.
- Komunikimin në formate të përshtatshme për kontekstin lokal dhe përshtatjen e metodave bazuar në reagimet e pranura.
- Përcaktimin e afateve dhe metodave për shpërndarjen e informacionit dhe konsultim.
- Promovimin e kuptimit të rreziqeve mjedisore dhe sociale dhe masave zbutëse.
- Vendosjen dhe mirëmbajtjen e mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA).
- Monitorimin dhe dokumentimin e aktiviteteve dhe përgjegjësi në kuadër të PAPI.
- Ofrimin e përditësimeve të rregullta për palët e interesit dhe menaxhmentin e projektit.

Palët e interesit do të informohen për qëllimet dhe aktivitetet e projektit, masat zbutëse mjedisore dhe sociale, si dhe për mekanizmin për trajtimin e ankesave, në përputhje me strategjinë për shpërndarjen e informacionit. Frekuenca dhe forma e angazhimit do të përshtaten sipas fazës së projektit dhe nevojave të palëve të interesit. Plani i shkurtuar për marrjen e tokës do t'u publikohet palëve të interesit përpara paraqitjes së çdo oferte për kompensim lidhur me ndikimet në pronë.

Takimet publike dhe mundësitë për angazhim do të komunikohen përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë postën elektronike, faqet zyrtare në internet, tabelat e njoftimeve dhe mediat lokale, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe proaktive.

Ky PAPI është dokument i gjallë/dinamik dhe do të përditësohet sipas nevojës gjatë zhvillimit të projektit.

5.2 Përmbledhje e nevojave të palëve të interesit, me metodat, mjetet dhe teknikat për publikimin e informacionit dhe angazhimin

Metoda të ndryshme të angazhimit janë propozuar për të adresuar nevojat specifike të secilit grup të palëve të interesit, siç paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 5. Nevojat e palëve të interesit (përmbledhje)

Grupi i palëve të interesit	Nevoja gjuhësore	Mjetet / format e preferuara për publikimin e informacionit dhe komunikimin	Nevoja specifike (qasshmëria, shkronja të mëdha, kujdesi për fëmijët, takimet gjatë ditës, etj.)
Institucionet qeveritare (p.sh. MMPHI, komunat, etj.)	Gjuhët zyrtare (kryesisht shqip dhe serbisht)	• Shkresa zyrtare • Takime me ministri, komuna dhe institucione të tjera qeveritare • Email • Raporte • Publikime / lajme në ueb-faqe	• Takime koordinuese gjatë orarit standard të punës • Qasje në dokumentacionin teknik • Përditësime të rregullta mbi progresin dhe ndryshimet në politika



Komunitetet / banorët brenda ose pranë lokacioneve të projektit	Shqip (dhe serbisht, sipas rastit)	- Takime komunitare - Fletëpalosje / postera - Njoftime nga pushteti lokal - Media (radio/TV) - Platforma online	- Masa për qasje (p.sh. materiale me shkronja të mëdha) - Përcaktimi i orarit të takimeve në përputhje me orarin e punës së komunitetit - Planifikimi i takimeve dhe aktiviteteve në kohë të përshtatshme për anëtarët e komunitetit që punojnë dhe për prindërit/nënat
Pronarët dhe përdoruesit e tokës	Shqip, serbisht	- Takime të drejtpërdrejta - Letra/email-e - Njoftime përmes zyrave komunale	- Procese transparente të blerjes së tokës në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe KP5 të BERZH-it, cilado qoftë më e rreptë. - Udhëzime për kompensim në formate të qasshme
Punëtorët e ndërtimit	Shqip (dhe serbisht, sipas rastit)	- Njoftimet në vendin e punës - Takime - Përditësime me email - Kodi i sjelljes - Kontrata	- Trajnim mbi shëndetin dhe sigurinë në punë - Qasja në pajisjet personale mbrojtëse (PPM) - Inspektime të rregullta të sigurisë në vend - Kuptimi i kodit të sjelljes dhe MTA-së
Prodhuesit/fermerët bujqësorë	Shqip dhe serbisht	- Takime publike konsultuese - Letra/email-e - Njoftime përmes zyrave komunale - Posterë - Reklama televizive/radio - Mediat sociale	- Plane për qasje në tokë gjatë ndërtimit - Kufizimet e tokës gjatë ndërtimit - Njoftim paraprak për ndërprerje të mundshme
Entitetet e sektorit privat (bizneset, shoqatat e biznesit)	Gjuhët zyrtare	- Shkresa zyrtare - Email-et - Tryeza të rrumbullakëta - Takime	- Informacion i përshtatur mbi përfitimet e projektit dhe ndikimet e mundshme në biznese - Procese transparente të prokurimit dhe kontraktimit
KEDS (Kompania e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike e Kosovës)	Shqip	- Komunikimet zyrtare - Takime koordinuese - Përditësime me email - Raportet e progresit	- Njoftim i hershëm për ndërprerjet e planifikuara - Oraret e detajuara për ndërtimin dhe riparimet - Mekanizmat për informimin e menjëhershëm të konsumatorëve
Konsumatorët e energjisë	Gjuhët zyrtare	- Media (TV/radio/media sociale) - Përditësime në ueb-faqe zyrtare - Njoftime me SMS/email	- Komunikim paraprak për ndërprerjet - Udhëzues të thjeshtuar mbi përfitimet e projektit
Organizatrat e Shoqërisë Civile (OSHC)	Shqip, Serbisht	- Konsultimet publike - Punëtori - Raporte - Rrjetet sociale	- Lokacione të qasshme - Përfshirje në takime vendimmarrëse - Informacion në formate të thjeshtuara për audienca jo-teknike - Platforma bashkëpunuese për pranimin e reagimeve



Media	Shqip, Serbisht	- Komunikata për shtyp - Konferenca për shtyp - Email	- Përditësime të rregullta dhe të thjeshtuara mbi projektin - Disponueshmëria e zëdhënësve për intervista
Donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat e zhvillimit (p.sh. BE-ja)	Anglisht	- Raportet zyrtare - Email-et - Konferenca	- Përmbledhje të progresit të nivelit të lartë - Përditësime të rregullta të ndikimit financiar

5.3 Strategjia për publikimin e informacionit dhe konsultimet

Përgjatë ciklit të projektit, agjencia zbatuese e projektit (KOSTT) do të publikojë me kohë informacionin lidhur me objektivat, komponentët, aktivitetet e planifikuara, rreziqet, ndikimet, mekanizmin për trajtimin e ankesave, konsultimet publike, progresin e projektit dhe proceset e tjera përkatëse, ndaj palëve të interesit, siç përshkruhet në tabelën në shtojcën 2. Të gjitha palëve të interesit do t'u sigurohet qasje në informacion të besueshëm, kuptimplotë dhe të plotë për Projektin, i paraqitur në mënyrë që merr parasysh kushtet specifike lokale, si dhe preferencat kulturore dhe gjuhësore të komuniteteve lokale. Kjo mund të nënkuptojë që informacioni do të duhet të ofrohet në formate të ndryshme për të përmbushur nevojat e audiencave të ndryshme.

Plani për publikimin e informacionit dhe konsultimin me palët e interesit i paraqitur në shtojcë është përshtatur në varësi të nevojave të secilit grup të identifikuar të palëve të interesit.

Strategjia e saktë e angazhimit, si dhe detajet mbi kohën dhe vendndodhjen/lokacionin e takimeve publike, do të përcaktohen pasi të përfundojë dizajnimin i komponentëve të ndryshëm të projektit dhe do të përfshihen në versionin e përditësuar të PAPI. Plani i angazhimit të palëve të interesit do të përditësohet rregullisht gjatë zhvillimit të projektit.

Strategjia e propozuar për publikimin e informacionit dhe konsultimin është e paraqitur në Shtojcën 2.

5.4 Strategjia e propozuar për përfshirjen e pikëpamjeve të grupeve të cënueshme

KOSTT është i përkushtuar të sigurojë pjesëmarrje kuptimplotë të individëve dhe grupeve në pozitë të pafavorshme dhe të cënueshme - siç janë gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet romë dhe të rinjtë - gjatë gjithë procesit të konsultimit. Do të zbatohen një sërë masash të përshtatura për të larguar barrierat dhe për të garantuar angazhim gjithëpërfshirës.

Këto masa përfshijnë:

- **Metoda të ndryshme të angazhimit:** Përdorimi i formateve të caktuara siç janë fokus grupet, seancat e ndara, platformat online dhe dorëzimet me shkrim.
- **Qasshmëria:** Sigurimi që vendet e takimeve të jenë të qasshme, ofrimi i interpretimit në gjuhën e shenjave, materialeve të thjeshtuara dhe mbështetje për transport ose kujdes për fëmijë. Formate të veçanta për gra dhe të rinj do të përdoren kur është e përshtatshme.
- **Ndjeshmëria kulturore:** Adaptimi i qasjes më të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme nga ana kulturore për të nxitur dialog të sigurt dhe gjithëpërfshirës.
- **Ndërtimi i kapaciteteve:** Ofrimi i trajnimeve dhe sesioneve informuese për të fuqizuar pjesëmarrjen kuptimplotë, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë.
- **Mekanizmi gjithëpërfshirës për trajtimin e ankesave:** Sigurimi që mekanizmat e ankesave të jenë të qasshëm, të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe të përshtatshëm për të rinjtë.
- **Qasja e barabartë në përfitime:** Hartimi i masave për të siguruar që grupet e cënueshme të mund të përfitojnë plotësisht nga projekti.



Përmes këtyre përpjekjeve, projekti synon të sigurojë që zërat e grupeve të cënueshme të integrohen në mënyrë aktive në procesin e vendimmarrjes dhe zbatimit.

6. Shqyrtimi i komenteve / raportimi ndaj palëve të interesit

KOSTT do të sigurojë që palët e interesit të informohen rregullisht për progresin e projektit, duke përfshirë performancën mjedisore dhe sociale, zbatimin e PAPI-t dhe funksionimin e mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA). Reagimet e mbledhura përmes kanaleve të ndryshme - siç janë takimet, parashtresat me shkrim, konsultimet, anketat dhe MTA - do të shqyrtohen në mënyrë sistematike dhe do të integrohen në procesin e vendimmarrjes, krahas konsideratave teknike dhe rregullatore.

Projekti është i përkushtuar për të mbyllur ciklin e reagimeve duke raportuar se si kontributi i palëve të Interesit ndikoi në vendimet përfundimtare. Këto përmbledhje do të jenë pjesë e raportit gjysmëvjetor të zbatimit të PAPI-t, do të ndahet me BERZH-in dhe do të publikohet në faqen e internetit të KOSTT/projektit për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

7. Burimet financiare dhe kapacitetet institucionale për zbatimin e angazhimit të palëve të interesit

7.1 Burimet

Meqenëse projekti ndodhet në fazë të hershme të vlerësimit, buxheti për angazhimin e palëve të interesit ende nuk është finalizuar. Një buxhet i detajuar do të përfshihet në versionin e përditësuar të PAPI-t, i cili do të përgatitet dhe publikohet para hyrjes në fuqi të projektit, duke siguruar që të gjitha palët të jenë të informuara dhe të angazhuara gjatë gjithë ciklit të projektit. Më poshtë paraqitet një përmbledhje orientuese e kategorive buxhetore për aktivitetet e planifikuara të angazhimit.

Tabela 6. Kategoritë orientuese buxhetore për zbatimin efektiv të aktiviteteve të angazhimit

Kategoritë buxhetore	
1. Pagat e stafit dhe shpenzimet përkatëse	4. Trajnime
1a. Ekspertë/staf që do të punësohen në kuadër të këtij projekti	4a. Trajnime mbi çështje sociale/mjedisore për stafin e KOSTT-it/projektit dhe stafin e kontraktuar, sipas nevojës
1b. P.sh. Shpenzimet e udhëtimit për stafin	
2. Ngjarjet	5. Anketimet e përfituesve
2a. Takime për lansimin e projektit	5a. Anketa e përceptimit
2b. Organizimi i fokus grupeve	6. Mekanizmi i ankesave
2c. Zhvillimi i anketave	6a. Trajnimi i stafit të KOSTT-it për menaxhimin e MTA-së
3. Fushata e komunikimit	6b. Themelimi i pikave lokale të pranimit
3a. Postera, fletëpalosje	6c. Materiale komunikimi për MTA
3b. Fushata në rrjete sociale	7. Shpenzime të tjera
3c. Punëtori	7a. Udhëtime, akomodim etj.



7.2 Funksionet menaxheriale dhe përgjegjësitë

Projekti do të zbatohet nga KOSTT, e cila do të menaxhojë gjithashtu zbatimin e planit të angazhimit të palëve të interesit (PAPI) dhe do të lehtësojë komunikimin me palët e interesit. Vendimet lidhur me angazhimin e stafit, përfshirë emërimin e ekspertëve mjedisorë dhe socialë, janë ende në proces.

KOSTT do të caktojë një person të dedikuar, si p.sh. një ekspert social, për të udhëhequr angazhimin e palëve të interesit. Ky rol përfshin menaxhimin e komunikimit, organizimin e konsultimeve, trajtimin e pyetjeve, mbikëqyrjen e mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA) dhe sigurimin që kontributet e palëve të interesit të merren parasysh në procesin e vendimmarrjes, duke reflektuar përkushtimin e KOSTT-it për angazhim gjithëpërfshirës.

Përgjegjësitë kryesore të personit përgjegjës përfshijnë:

- Hartimin dhe zbatimin e strategjive për angazhimin e palëve të interesit në përputhje me objektivat e projektit;
- Sigurimin e komunikimit gjithëpërfshirës, transparent dhe mekanizmave efektivë të reagimit;
- Organizimin e konsultimeve, forumeve dhe sesioneve informuese;
- Menaxhimin e platformave digjitale dhe përditësimin e informatave publike;
- Monitorimin e efektivitetit të angazhimit dhe propozimin e përmirësimeve;
- Mbështetjen e ekipeve të projektit dhe veprimin si ndërlidhës me palët e jashtme të interesit.

Të gjithë kontraktorët e angazhuar në aktivitetet e projektit do të jenë të obliguar të respektojnë dispozitat e PAPI-t. Kërkesat për menaxhimin e ankesave do të përfshihen në dokumentet e tenderimit dhe në detyrimet kontraktuale.



8. Mekanizmi për trajtimin e ankesave (MTA)

KOSTT do të themelojë dhe menaxhojë një mekanizëm të qasshëm dhe transparent për trajtimin e ankesave (MTA), me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e shqetësimeve që lidhen me projektin, përfshirë ndikimet mjedisore dhe sociale. Mekanizmi do të jetë pa pagesë, i përshtatshëm nga aspekti kulturor dhe i disponueshëm për të gjithë personat dhe organizatat e prekura nga projekti, pa frikë nga hakmarrja apo pasoja negative.

MTA do të mbështesë disa kanale pranimi të informatave, duke mundësuar trajtim të shpejtë dhe efektiv të ankesave. Gjithashtu do të përfshijë procedura për pranimin dhe referimin konfidencial dhe të sigurt të ankesave që lidhen me dhunën me bazë gjinore (DBG), drejt ofruesve përkatës të shërbimeve.

Personi përgjegjës për MTA-në (eksperti social) do të mbikëqyrë pranimin, dokumentimin dhe koordinimin e ankesave. Ky rol kërkon kualifikime përkatëse ose trajnim adekuat për të siguruar menaxhim efektiv.

Ankesat mund të parashtrohen përmes:

- Telefonit, SMS ose emailit
- Uebfaqes së KOSTT-it (përfshirë formularin e ankesave – Shtojca 1)
- Mediat sociale (p.sh. Facebook, Instagram)
- Dorëzimi manual i formularit të ankesës.

Formulari i ankesës do të jetë i disponueshëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe do të publikohet online si dhe përmes komunave të prekura.

Të gjitha ankesat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe me respekt. Ankuesit mund të kërkojnë anonimitet; megjithatë, ankesat anonime nuk do të marrin përgjigje individuale. Të gjitha ankesat, përfshirë ato anonime, do të regjistrohen dhe do të përfshihen në raportimin e përgjithshëm mjedisor dhe social të kompanisë ndaj BERZH-it, i cili bëhet në baza vjetore. Incidentet dhe aksidentet serioze do të raportohen menjëherë, jashtë ciklit të rregullt të raportimit, për të siguruar veprim në kohë dhe përputhje me kërkesat e BERZH-it.

Detajet e kontaktit për MTA do të publikohen në mënyrë publike përmes ueb-faqes, materialeve të shtypura dhe formularëve të ankesave.

Informatat e kontaktit për paraqitjen e ankesave dhe kërkesave për informim

Emri dhe pozita: Minivere Idrizi

Adresa: KOSTT: Rr. Isa Boletini. Nr. 39, 10000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: minivere.idrizi@kostt.com

Telefoni: + 383 (0)38 501 301 049

Ueb-faqja e KOSTT-it do të ofrojë udhëzime të qarta për palët e interesit mbi mënyrën e paraqitjes së komenteve, pyetjeve, shqetësimeve dhe ankesave. Gjithashtu do të shpjegojë mënyrën e funksionimit të mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA), përfshirë hapat dhe afatet kohore.

Mekanizmi për trajtimin e ankesave të punëtorëve

Në kuadër të projektit do të zhvillohet edhe një mekanizëm të veçantë për trajtimin e ankesave të punëtorëve, për punëtorët e drejtpërdrejtë dhe ata të kontraktuar, me qëllim që të parashtrojnë shqetësime që lidhen me vendin e punës. Ky mekanizëm është i ndarë nga mekanizmi për komunitetin dhe menaxhohet nga KOSTT dhe secili punëdhënës përkatës. Punëtorët do të informohen për ekzistencën e këtij mekanizmi në momentin e rekrutimit, përfshirë mbrojtjen kundër hakmarrjes. Ankesat që lidhen me marrëdhënien e punës do të regjistrohen, shqyrtohen dhe adresohen në mënyrë transparente dhe të drejtë.



KOSTT do të sigurojë që procedura për mekanizmin e ankesave të punëtorëve të jetë në fuqi para hyrjes në fuqi të projektit dhe të pasqyrohet në kontratat e punëtorëve. KOSTT do të mbikëqyrë zbatimin e këtij mekanizmi nga të gjithë kontraktorët dhe nënkontraktorët. Në rast se kontraktorët nuk kanë një mekanizëm të vendosur për ankesat e punëtorëve, KOSTT ose do ta zgjerojë mekanizmin e vet për t'u aplikuar edhe për ata kontraktorë, ose do të kërkojë nga kontraktorët që të zbatojnë një mekanizëm për ankesat e punëtorëve në përputhje me standardet e KOSTT-it.

8.1 Menaxhimi i mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA)

Procesi i zgjidhjes së ankesave ndjek hapa të strukturuar, në përputhje me diagramin e rrjedhës së MTA-së dhe afatet kohore të përcaktuara. MTA është hartuar për të identifikuar zgjidhje dhe për të ofruar masa korrigjuese në burim, në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Është e rëndësishme të theksohet se MTA nuk ofron këshilla juridike; ofrimi i këshillave ligjore për palët e jashtme të interesit mund të çojë në keqkuptime ose të nxisë pa dashje ankesa të reja. Palët e interesit që përdorin MTA-në nuk kufizohen nga përdorimi i mekanizmave të tjerë të ankesave ose nga ndjekja e rrugëve ligjore të parashikuara nga legjislacioni kombëtar. MTA synon zgjidhjen efikase të ankesave përpara se ato të përshkallëzohen në raste formale ligjore, duke ruajtur të drejtën e individëve për të zgjedhur mekanizmin që preferojnë.

Procesi i zgjidhjes së ankesave përfshin hapat e mëposhtëm të strukturuar, në përputhje me diagramin e rrjedhës së MTA-së dhe afatet kohore:

Hapi 1: Konfirmimi i pranimit dhe regjistrimi: Ankesat e pranuar përmes kanaleve të përcaktuara shqyrtohen dhe konfirmohen nga KOSTT brenda 5 ditëve kalendarike. Ankuesi njoftohet me shkrim dhe identifikohet personi përgjegjës për trajtimin e rastit (përveç rasteve kur ankesa është anonime). Çdo rast regjistrohet dhe i caktohet një numër unik identifikues në regjistrin e ankesave.

Hapi 2: Filtrimi dhe vlerësimi: KOSTT vlerëson nëse ankesa hyn në kompetencën e saj dhe nëse ankuesi ka bazë të vlefshme për paraqitjen e saj. Ankesat kategorizohen sipas nivelit të rrezikut (i lartë, i mesëm ose i ulët) dhe lidhjes me aktivitetet e projektit. Nëse ankesa vlerësohet që nuk lidhet me projektin, një përgjigje formale jepet brenda 5 ditëve nga konfirmimi i pranimit.


Hapi 3 : Hetimi: Pason një hetim i detajuar, duke përfshirë mbledhjen e informacionit shtesë kur është e nevojshme. Nëse ankesa nuk është e qartë dhe ankuesi nuk përgjigjet ndaj kërkesave për sqarim, KOSTT nxjerr një përfundim formal duke shpjeguar arsyet pse ankesa nuk mund të vazhdojë.

Hapi 4: Zgjidhja: KOSTT ndërmerr masa të përshtatshme korrigjuese për të zgjidhur çështjen. Nëse kërkohen veprime afatgjata, ankuesi njoftohet brenda 15 ditëve kalendarike. Të gjitha ankesat duhet të zgjidhen brenda 30 ditëve kalendarike. Një përfundim me shkrim i komunikohet ankuesit dhe palëve përkatëse. Nëse zgjidhja nuk është e mundur, ofrohet arsyetim dhe sqarohen hapat e mëtejshëm.

Hapi 5: Monitorimi pas zgjidhjes: Monitorimi pas zgjidhjes realizohet brenda 5 ditëve pune nga momenti i përfundimit të rastit, me qëllim verifikimin e zbatimit të masave të dakorduara dhe sigurimin që ankuesi është informuar për rezultatin. Në rast se ankuesi nuk është i kënaqur me zgjidhjen e ofruar, ai/ajo ruan të drejtën për të ndjekur mjete juridike në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe informohet për opsionet përkatëse të ankimit.



Figura 1: Diagrami i rrjedhës së mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA)





8.2 Monitorimi dhe raportimi i mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA)

KOSTT do të sigurojë që të gjitha ankesat e pranuar të regjistrohen në mënyrë të rregullt në një regjistër të posaçëm të ankesave ose në një bazë të dhënash përkatëse (shih shtojcën 2 për një model të formularit). Ky regjistër do të evidentojë dhe ndjekë çështjet e ngritura nga individë ose grupe dhe do të përfshijë:

1. Numrin referues / të regjistrimit
2. Datën dhe mënyrën e pranimit
3. Përshkrimin e ankesës
4. Nën-projektin ose aktivitetin përkatës
5. Statusin e ankuesit (p.sh. person i prekur nga projekti, anëtar i komunitetit)
6. Gjininë dhe përkatësinë etnike (nëse është e disponueshme)
7. Datën e konfirmimit të pranimit
8. Veprimet e ndërmarra (p.sh. hetimi, zgjidhja)
9. Datën e zgjidhjes dhe dhe përgjigjen e dhënë

Personi përgjegjës për MTA-në do të përmbledhë të dhënat mbi ankesat, kërkesat për informim dhe komentet në raporte gjashtëmujore, të cilat do t'i dorëzohen BERZH-it dhe do të publikohen në ueb-faqen e KOSTT-it / projektit, me qëllim promovimin e transparencës.

Treguesit kryesorë të monitorimit mund të përfshijnë:

- Numrin total të ankesave të pranuar
- Përqindjen e ankesave të zgjidhura
- Kohën e zgjidhjes sipas kategorisë
- Respektimin e afateve për trajtimin e ankesave
- Nivelin e kënaqësisë së ankuesve
- Qasjen publike në MTA.

Për të siguruar efektivitetin e tij, MTA do t'i nënshtrohet auditimeve të rregullta.

9. Monitorimi dhe raportimi

KOSTT është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit në kuadër të projektit. Personi përgjegjës, zakonisht ekspertët socialë, do të mbikëqyrin këto aktivitete në të gjithë komponentët dhe operacionet. Roli i tyre përfshin ekzekutimin e PAPI-t, ndjekjen e aktiviteteve, mbledhjen e reagimeve, vlerësimin e efektivitetit dhe ndërmarrjen e përmirësimeve për të siguruar angazhim të vazhdueshëm gjatë gjithë ciklit të Projektit. Përgjegjësitë kryesore përfshijnë:

- **Mbikëqyrja e planit:** Menaxhimi i zbatimit të PAPI-t, duke siguruar që aktivitetet të jenë në përputhje me strategjitë dhe objektivat e tij.
- **Gjurmimi i aktiviteteve:** Monitorimi i veprimeve të angazhimit, si konsultimet, takimet dhe mbledhja e komenteve, për të siguruar realizimin në kohë.
- **Përmbledhja e komenteve:** Mbledhja dhe dokumentimi i kontributeve të palëve të interesit, duke reflektuar shqetësime dhe perspektiva të ndryshme.
- **Vlerësimi i efektivitetit:** Vlerësimi nëse aktivitetet e angazhimit po arrijnë rezultatet e synuara dhe po kontribuojnë në marrëdhënie pozitive me palët e interesit.
- **Përshtatja e planit:** Ndërmarrja e përmirësimeve bazuar në rezultatet e monitorimit për të siguruar që PAPI të mbetet relevant dhe reagues.
- **Menaxhimi i komunikimit:** Sigurimi i komunikimit të qartë dhe në kohë ndërmjet projektit dhe palëve të interesit, si dhe trajtimi i komenteve në mënyrë të përshtatshme.
- **Raportimi:** Përgatitja e raporteve të detajuara të monitorimit, që paraqesin rezultatet e angazhimit dhe fushat për përmirësim.
- **Bashkëpunimi:** Koordinimi me ekipet e projektit dhe palët e jashtme të interesit për të integruar komentet në vendim marrjen e projektit.
- **Ndërtimi i kapaciteteve:** Ofrimi i trajnimeve për ekipet mbi praktikën më të mirë të angazhimit, për të siguruar zbatim të qëndrueshëm.



- **Pajtueshmëria me standardet:** Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret përkatëse dhe standardet etike gjatë gjithë ciklit të PAPI-t.

KOSTT do të sigurojë gjithashtu që veprimet pasuese - të tilla si ndarja e rezultateve të konsultimeve dhe masave korrigjuese - të zbatohen dhe të komunikohen në mënyrë efektive tek palët e interesit, duke mbyllur ciklin e reagimit dhe duke forcuar llogaridhënien.

Raportet gjashtëmujore për angazhimin e palëve të interesit do t'i dorëzohen BERZH-it, duke përfshirë përshkrimin e aktiviteteve të konsultimit, gjetjet kryesore, masat zbutëse dhe mësimet e nxjerra. Këto raporte do të publikohen për të siguruar transparencë dhe për të treguar se si kontributet e palëve të interesit janë reflektuar në zbatimin e projektit.

10. Publikimi dhe konsultimi

Pas miratimit nga BERZH-i, versioni i përditësuar i PAPI-t do të publikohet në ueb-faqen e KOSTT-it në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze për një periudhë dyjavore rishikimi publik, e ndjekur nga një proces konsultimi. Ftesa do të publikohet përmes mediave kombëtare me qasje të gjerë, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të palëve të interesit. Ajo do të përfshijë detaje mbi mënyrën e qasjes në PAPI, informacionin për projektin, organizimin e konsultimit dhe të dhënat e kontaktit për paraqitjen e komenteve.

Pas konsultimeve, procesverbalet e takimit, që dokumentojnë komentet e palëve të interesit dhe përgjigjet përkatëse, do t'i bashkëngjiten PAPI-t si shtojcë. Pjesëmarrja do të regjistrohet dhe, kur lejohet, do të mbështetet me fotografi. Versioni përfundimtar i PAPI-t, që reflekton kontributet e palëve të interesit dhe është miratuar nga BERZH-i, do të mbetet i disponueshëm publikisht gjatë gjithë ciklit të projektit.



Shtojca 1: Korniza ligjore dhe rregullatore për angazhimin e palëve të interesit

Korniza ligjore kombëtare e Kosovës për angazhimin e palëve të interesit

Nevoja për publikimin e informacionit dhe konsultimin publik mbështetet në dispozita specifike të legjislacionit kombëtar përkatës:

- **Ligji për mbrojtjen e mjedisit nr. 03/L-025** obligon institucionet qendrore dhe lokale, si dhe organet e autorizuar, të informojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe objektive publikun për gjendjen e mjedisit, cilësinë e tij, emisionet, masat paralojmëuese dhe ndotjen e mundshme që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e njeriut. Ky ligj garanton përfshirjen e publikut në proceset e vendimmarrjes.
- **Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis nr. 08/L-181** rregullon procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), duke kërkuar që autoritetet të organizojnë dëgjime publike për projektet që kërkojnë VNM. Ligji parasheh zhvillimin e debateve publike mbi raportin e VNM-së, dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh në vendimet për dhënien e pëlqimit mjedisor.
- **Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L-139** në Kosovë rregullon jo vetëm marrjen e tokës dhe zhvendosjen, por përmban edhe dispozita të detajuara lidhur me komunikimin dhe informimin gjatë procesit të marrjes së tokës. Sipas këtij ligji, autoriteti përgjegjës për shpronësim, brenda 10 ditëve pune nga miratimi i vendimit për aprovimin e kërkesës për shpronësim, duhet t'u sigurojë të gjithë bartësve të identifikuar të të drejtave pronësore dokumentet dhe informacionin e nevojshëm. Ky vendim publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në gazetatat ditore, duke filluar një afat 10-ditor gjatë të cilit palët e interesit mund të paraqesin komente me shkrim pranë autoritetit shpronësues. Përveç kësaj, ligji kërkon që autoriteti shpronësues të organizojë një dëgjim publik brenda 15 ditëve në secilën komunë ku ndodhen pronat që i nënshtrohen shpronësimit.
- **Udhëzimi Administrativ për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e VNM-së** përcakton mënyrat e njoftimit të publikut dhe lehtësimin e përfshirjes së tij gjatë gjithë procesit të VNM-së.

Për më tepër, ligje të tjera përkatëse që miratojnë zbulimin e informacionit të projektit dhe nxisin qasjen në informacion, së bashku me mekanizmat për ankesa dhe apeline, përfshijnë:

- **Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës** garanton të drejtën e çdo individi për të pasur qasje në dokumente publike, me kufizime vetëm në informacionin privat, sekretet afariste dhe të dhënat e mbrojtura ose të klasifikuara.
- **Ligji për qasje në dokumente publike Nr. 06/L-081** i siguron çdo individi, pa diskriminim, të drejtën për të pasur qasje në dokumente zyrtare të mbajtura nga institucionet publike, pas paraqitjes së kërkesës përkatëse, në përputhje me kufizimet e nenit 4 të Kushtetutës.

Në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor, publiku duhet të informohet dhe të angazhohet gjatë gjithë zhvillimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit urban dhe hapësinor.

Për më tepër, Kosova nuk është nënshkruese e **Konventës së Aarhusit mbi qasjen në informacion, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore**. Megjithatë, legjislacioni kombëtar përputhet gjerësisht me parimet e Konventës, duke integruar shumicën e parimeve të saj brenda kornizës ligjore.

Politikat e BERZH-it për angazhimin e palëve të interesit

Kërkesa e performancës 10 (KP10) politikës mjedisore dhe sociale të BERZH-it përcakton qasjen e bankës ndaj angazhimit të palëve të interesit dhe publikimit të informacionit. KP10 në thelb përshkruan angazhimin e BERZH-it për transparencë, publikimin e informacionit dhe angazhimin e palëve të interesit gjatë gjithë ciklit të projektit.



Ajo thekson rëndësinë e komunikimit efektiv me palët e interesit, si në aspektin e ndarjes së informacionit rreth projekteve ashtu edhe në përfshirjen aktive të tyre në proceset e vendimmarrjes.

Disa nga elementet kryesore të përfshira zakonisht në KP 10 janë:

- **Qasja në informacion:** Sigurimi që palët e interesit të kenë qasje në informacionin që lidhet me projektin, siç janë detajet e projektit, ndikimet e mundshme dhe masat zbutëse.
- **Konsultimi dhe pjesëmarrja:** Nxitja e konsultimit kuptimplotë me komunitetet e prekura, autoritetet lokale, OJQ-të dhe palë të tjera përkatëse të interesit. Qëllimi është mbledhja e komenteve, adresimi i shqetësimeve dhe integrimi i njohurive lokale në projektim dhe zbatim.
- **Transparenca në vendimmarrje:** Promovimi i transparencës në proceset e vendimmarrjes që lidhen me miratimin, projektimin dhe zbatimin e projektit, përfshirë publikimin e mënyrës se si kontributet e palëve të interesit ndikojnë në këto vendime.
- **Mekanizmat për trajtimin e ankesave:** Vendosja e mekanizmave për trajtimin e ankesave dhe shqetësimeve nga palët e prekura, duke u mundësuar atyre të paraqesin shqetësime dhe të kërkojnë zgjidhje për çështje që lidhen me projektin.
- **Angazhimi i vazhdueshëm:** Nxitja e angazhimit të vazhdueshëm dhe efektiv gjatë gjithë ciklit të projektit, duke i mbajtur palët e interesit të informuara për progresin, momentet kyçe dhe ndryshimet eventuale.

KP10 e BERZH-it synon të harmonizohet me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit dhe publikimin e informacionit, duke siguruar që projektet të zbatohen në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, duke marrë parasysh shqetësimet dhe perspektivat e komuniteteve dhe individëve të prekur. Për informacionin më të përditësuar dhe të detajuar mbi KP 10 ose ndryshime të politikave përkatëse, rekomandohet referimi në dokumentacionin zyrtar ose në ueb-faqen e BERZH-it.

Shtojca 2: Strategjia e propozuar për publikimin e informacionit dhe konsultimet

Tabela 3: Strategjia e propozuar për publikimin e informacionit dhe konsultimet

Tema e konsultimit / Qëllimi	Me kë? (palët e synuara të interesit)	Metodat e propozuara	Përgjegjësia
Prezantimi i projektit, përfshirë komponentët, aktivitetet kryesore, afatet kohore, vendndodhjen, rreziqet, ndikimet dhe përfitimet e pritshme	Të gjitha palët kryesore të interesit, përfshirë personat e prekur nga projekti (PPP), bizneset, institucionet qeveritare, komunat, konsumatorët e energjisë etj.	- Konsultime publike (veçanërisht për individët dhe bizneset e prekura) - Takime zyrtare (p.sh. me ministrinë kryesore, agjencitë, komunat). - Takime me përfaqësues të biznesit (që do të preken nga aktivitetet e projektit) - Publikime në ueb-faqe - Postime në rrjetet sociale - Reklama në TV dhe radio	KOSTT
Vlerësimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe masat zbutëse	Komunitetet e prekura, organizatat mjedisore dhe OSHC-të e tjera, agjencitë qeveritare përkatëse	- Konsultime publike në komunat e prekura me PAP dhe bizneset e prekura - Konsultime online (përdorimi i faqeve të internetit, platformës së konsultimit publik, platformave të tjera sipas nevojës) - Fokus grupe/tryeza të rrumbullakëta - Publikime në ueb-faqe - Shpërndarja e materialeve të shtypura (në komunat e prekura)	KOSTT, eksperti mjedisor ose mjedisor dhe social
Publikimi i informacionit mbi mekanizmin për trajtimin e ankesave (MTA), përfshirë procesin dhe mënyrën e paraqitjes dhe trajtimit të ankesave	Të gjithë palët e Interesit, publiku i gjerë	- Konsultime publike - Publikime në ueb-faqe - Postimet në rrjetet sociale - Email	KOSTT, komunat e prekura
Përditësime të rregullta mbi statusin e projektit, arritjet dhe sfidat (p.sh. monitorimi i zbatimit të standardeve të cilësisë nga laboratorët, monitorimi i përmirësimeve të PKK-ve, i sistemeve të taksës elektronike dhe masave të sigurisë rrugore, etj.)	- Ministrinë përkatëse (p.sh. MMPHI) - Komunat e prekura - Komunitetet dhe bizneset e prekura - BERZH - Publiku i gjerë	- Takime koordinuese me agjencitë kryesore qeveritare dhe BERZH-in - Konsultimet publike - Raportet e progresit (për BERZH-in dhe ministrinë përkatëse) - Buletinet - Publikime në ueb-faqe - Postimet në rrjetet sociale	KOSTT



Mundësitë e punësimit dhe proceset e prokurimit	• Punëtorët e ndërtimit dhe kompanitë e ndërtimit • Kërkuesit e punës • Bizneset lokale • Odat ekonomike	• Postimet në ueb-faqe të KOSTT dhe rrjetet sociale • Postime në platforma për kërkim pune (p.sh. kosovajob.com)	KOSTT (HR)
Masat e shëndetit dhe sigurisë gjatë zbatimit të projektit	• Punëtorët e projektit • Autoritetet lokale shëndetësore • Shërbimet emergjente	• Punëtori trajnimi për sigurinë • Broshura informuese • Auditime të rregullta të sigurisë • Konsultime publike për të informuar PAP-et • Postimet në ueb-faqe dhe në rrjetet sociale	KOSTT, Institucionet shëndetësore
Informimi i palëve të Interesit në lidhje me ndërprerjet e energjisë për shkak të punimeve të ndërtimit	• Komunitetet e prekura • Bizneset e prekura • Institucionet publike	• Njoftime publike • Shpërndarja e fletëpalosjeve • Përditësimet e ueb-faqes • Njoftimet në rrjetet sociale • Media lokale (TV, radio) • Alarme SMS	KOSTT dhe KEDS

Shtojca 3: Përmbledhje e aktiviteteve të mëparshme të angazhimit të palëve të interesit

KOSTT angazhon palët e jashtme të interesit përmes publikimit sistematik të informacionit dhe zhvillimit të konsultimeve, në përpjesëtim me natyrën dhe fazën e aktiviteteve të saj. Angazhimi zakonisht realizohet përmes njoftimeve publike, përditësimeve në ueb-faqe dhe buletin, komunikatave për shtyp, si dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me pronarët e tokave të prekura, banorët, bizneset, komunat dhe ministritë përkatëse. Kur kërkohet, informacioni jo-teknik i projektit publikohet dhe konsultimet publike zhvillohen në përputhje me procedurat kombëtare të VNM-së. KOSTT mban gjithashtu komunikim të vazhdueshëm me palët ndërkombëtare të interesit, përfshirë financuesit, përmes raportimit të rregullt mjedisor dhe social.

Për projektin e propozuar, aktivitetet e deritanishme të informimit dhe angazhimit specifik për projektin paraqiten në tabelën më poshtë:

Aktiviteti	Data dhe vendndodhja	Pjesëmarrësit	Diskutimet dhe rezultatet kryesore
Njoftim në mediat sociale	15 Gusht 2024 / Në internet	Menaxhmenti i lartë i KOSTT; përfaqësues i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovën	Njoftim publik për një takim të nivelit të lartë midis KOSTT dhe BERZH-it, me fokus në nevojat e financimit të sektorit të energjisë në Kosovë. Njoftimi informoi publikun për nënshkrimin e një Letre Mandati si një hap fillestar drejt investimeve të mundshme në infrastrukturën e transmetimit, duke përfshirë një kredi të propozuar nga korporatat dhe mbështetje me grant. Postimi theksoi bashkëpunimin me BERZH-in dhe partnerët e zhvillimit, objektivat për modernizimin e rrjetit dhe angazhimin për përmirësimin e besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit energjetik.

Shtojca 4: Model i formularit të ankesës

Numri referues i ankesës:	
Emri i plotë (opsional) <i>Shënim: Mund të mbeten anonim nëse dëshironi, ose mund të kërkonit që identiteti juaj të mos zbulohet ndaj palëve të treta pa pëlqimin tuaj.</i>	
Anonimiteti	☐ Dëshiroj ta paraqes ankesën në mënyrë anonime ☐ Kërkoj që identiteti im të mos zbulohet pa pëlqimin tim
Të dhënat e kontaktit <i>Ju lutemi shënoni mënyrën e preferuar të kontaktit (postë, telefon, email):</i>	☐ Me postë - Ju lutemi jepni adresën postare: ☐ Me telefon: ☐ Me email:
Gjuha e preferuar e komunikimit:	☐ Shqip ☐ Serbisht ☐ Anglisht (nëse është e mundur)
Përshkrimi i incidentit / ankesës	Për çfarë bëhet fjalë në ankesën tuaj? ☐ Shkelje të rregulloreve dhe të politikave ☐ Ndikimet mjedisore dhe sociale ☐ Siguria dhe shëndeti publik ☐ Sjellje e pahijshme (p.sh., akuza për diskriminim, ngacmim) ☐ Çështje operationale ☐ Tjetër (Ju lutem specifikoni)
Çfarë ka ndodhur? Ku ka ndodhur? Kujt i ka ndodhur? Cili është rezultati i problemit? 	
Data e incidentit / ankesës	



Frekuenca e ankesës:	☐ Incident / ankesë e njëhershme (data: _____) ☐ Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____) ☐ Në vazhdimësi (problemi vazhdon aktualisht)
Çfarë zgjidhjeje do të dëshironit të shihnit?	

Ju lutemi dorëzojeni këtë formular në: *Të dhënat e kontaktit do të ofrohen nga KOSTT*	Nënshkrimi: _____ Data: _____
---	--

Shtojca 5: Shembull i një modeli të thjeshtë të regjistrit të ankesave

Regjistri i MTA-së duhet të përfshihet në raportet gjashtëmujore të progresit të projektit që i dorëzohen BERZH-it.

#	Data e pranimit të ankesës	Kanali i pranimit (p.sh. email, ueb-faqe, telefon etj.)	Klasifikimi i rrezikut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Përshkrim i përmbledhur	Anonim (Po/Jo)	Personi/stafi i caktuar për të trajtuar ankesën	Statusi (i zgjidhur, në pritje, i përshkallëzuar)	Data e zgjidhjes së ankesës	Komunikim në lidhje me zgjidhjen (Po/Jo, Përshkrimi, Data)
1									
2									
3									
4									
5									
6									